



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 10, datë 12.04.2018

**“Mbi miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.
për auditimin e brendshëm të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit
për vitin 2017”**

Në mbështetje të nenit 52, pika 1, shkronja (j), të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe të nenit 14, pika 1 dhe të nenit 15, pika 4 të “Statutit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë nr. 28, datë 3.11.2014, i ndryshuar, me propozim të Auditit të Brendshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Miratimin e raportit të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k. për auditimin e brendshëm të Sektorit të Teknologjisë së Informacionit për vitin 2017, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Teknologjisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar